Sipas nenit 27 paragrafi 2 pika 6 të Statutit të Institucionit Nacional Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Këshilli drejtues në mbledhjen e 16-të më datë 10.6.2025 e miratoi këtë:

Rregullore për përmirësimin profesional, arsimimin plotësues dhe specializimin e të punësuarve në IN Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut

нија
ІАКЕДОНИЈА - REPUBLIKA E MAQEDONISË
РКЕСТАР ЗА ЏЕЗ МУЗИКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИ
INSTITUTI NACIONAL
RKESTRA E XHAZ MUZIKËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERI
Бр.-Nr. 02-396/2
10.06 2025 год.-viti

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

СКОПЈЕ – SHKUP

Me këtë Rregullore rregullohen të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në IN Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejmë: Orkestra e Muzikës Xhaz) të Institucionit Nacional Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup për përmirësimin profesional, arsimin plotësues dhe specializimin, format, dinamika dhe kushtet nën të cilat ato mund të realizohen.

Neni 2

Përmirësimi profesional, arsimi plotësues dhe specializimi i të punësuarve në IN Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut është në funksion të krijimit të kushteve për kryerje më të suksesshme dhe më cilësore të punëve dhe detyrave të punës që i takojnë fushës së kompetencave të institucionit, si dhe për mirëmbajtjen, përkatësisht avancimin e aftësisë së punonjësit për punë në vendin e punës ku është i sistemuar.

FORMAT E PËRMIRËSIMIT PROFESIONAL, ARSIMIT PLOTËSUES DHE SPECIALIZIMIT

Neni 3

Përmirësimi profesional, arsimi plotësues dhe specializimi realizohen nëpërmjet formave vijuese.

- Provim profesional;

- Studime pasuniversitare;

- Studime doktorale; dhe

- Forma të tjera të përmirësimit dhe specializimit.

Neni 4

(1) Cikli i Dytë i studimeve (studime pasuniversitare, përkatësisht magjistër, master)
(2) Cikli i Tretë i studimeve (studime doktorale) për:

- Luajtja e instrumentit (Instrumente që janë pjesë përbërëse e Orkestrës së

Muzikës Xhaz e RMV-së) trombë, trombon, saksofon, piano, kitarë,

(2) Studimet pasuniversitare dhe studimet doktorale duhet të trajtojnë dhe të hulumtojnë tema nga fusha e:

- fusha e së drejtës, ekonomisë, komunikologjisë, gazetarisë dhe opinionit publik;
- menaxhmenti, marrëdhëniet me publikun, informatika dhe të tjera që do të kontribuojnë në rritjen e performancës dhe suksesit të institucionit në tërësi; dhe
- fusha të tjera që kanë rëndësi për realizimin e qëllimeve, vizionit, misionit dhe detyrave të institucionit.

Neni 5

Forma të tjera të përmirësimit dhe specializimit janë: seminare, punëtori, konferenca, simpoziume, kongrese, këshillime dhe lloje të tjera të trajnimit profesional. Të punësuarit në Orkestrën e Muzikës Xhaz kanë të drejtë, por edhe detyrim, nëpërmjet formave të tjera të përmirësimit profesional dhe specializimit, të përmendura në paragrafin e këtij neni, të investojnë vazhdimisht në njohuritë e tyre në varësi të karakteristikave dhe specifikave të vendit të tyre të punës, me ç'rast do të sigurojnë zhvillimin e tyre personal, si dhe zhvillimin e institucionit në tërësi.

FINANCIMI I PËRMIRËSIMIT PROFESIONAL, ARSIMIMIT PLOTËSUES DHE SPECIALIZIMIT

Neni 6

Përmirësimi profesional, arsimi plotësues dhe specializimi i të punësuarve në Orkestrën e Muzikës Xhaz të RMV-së financohen nga mjetet e parashikuara për atë qëllim në planin financiar të institucionit.

Neni 7

Përmirësimi profesional, arsimi plotësues dhe specializimi i të punësuarve në Orkestrën e Muzikës Xhaz të RMV mund të financohen edhe pjesërisht nga mjetet që do t'i miratohen punonjësit nga Orkestra e Muzikës Xhaz e RMV-së dhe pjesërisht nga burime dhe mjete të tjera (mjete personale, mjete nga sponsorizime, donacione dhe të ngjashme).

KUSHTET NË TË CILAT MIRATOHEN MJETE PËR PËRMIRËSIM PROFESIONAL, ARSIMIN PLOTËSUES DHE SPECIALIZIM

Neni 8

Mjetet për përmirësimin profesional, arsimin plotësues dhe specializimin, nëpërmjet formave të përmirësimit profesional, arsimit plotësues dhe specializimit, të përmendura në nenin 3 të kësaj Rregulloreje, miratohen nga Këshilli drejtues, mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga i punësuari në Orkestrën e Muzikës Xhaz të RMV-së drejtuar drejtorit.

Neni 9

Që Këshilli drejtues i Orkestrës së Muzikës Xhaz i RMV-së të mund të përgjigjet pozitivisht ndaj kërkesës së paraqitur, nga neni 8 i kësaj Rregulloreje, është e nevojshme që i punësuari t'i plotësojë kushtet vijuese:

- Të jetë në marrëdhënie të rregullt pune në Orkestrën e Muzikës Xhaz të RMV-së për së paku dy vite; dhe

- Të kryejë punë në vendin e punës për të cilin është i domosdoshëm përmirësimi i përhershëm profesional dhe/ose shkencor dhe arsimi plotësues, ndjekja e proceseve aktuale në fushë me qëllim të fitimit të njohurive të veçanta profesionale dhe të thelluara të nevojshme për kryerjen më të suksesshme dhe më cilësore të detyrave të punës

Neni 10

Për përmirësimin profesional, arsimin plotësues dhe specializimin nëpërmjet formave të tjera të përmirësimit profesional dhe specializimit, të përmendura në nenin 5 të kësaj Rregulloreje, vendos drejtori me iniciativë të tij ose mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga drejtuesi i njësisë organizative, përkatësisht nga punonjësi.

PROCEDURA PËR MIRATIMIN E MJETEVE PËR PËRMIRËSIM PROFESIONAL, ARSIMIN PLOTËSUES DHE SPECIALIZIMI

Neni 11

Kërkesa për miratimin e mjeteve për përmirësim profesional, arsimim plotësues dhe specializim, përmes formave të përmirësimit profesional, arsimimit plotësues dhe specializimit të përmendura në

nenin 3 paragrafi 1, 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje (provim profesional, studime pasuniversitare dhe studime doktorale) paraqitet te drejtori, i cili kërkesën së bashku me propozimin e dorëzon për miratim te Këshilli drejtues, në njërën nga mbledhjet e tij të rregullta. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për miratimin e mjeteve për përmirësim profesional, arsimin plotësues dhe specializimin, përparësi do të kenë kërkesat për të cilat pjesërisht janë siguruar mjete nga ana e të punësuarit në Orkestrën e Muzikës Xhaz të RMV, në përputhje me nenin 7 të kësaj Rregulloreje. Nëse Këshilli drejtues e pranon propozimin e drejtorit dhe e miraton kërkesën për miratimin e mjeteve, drejtori do të marrë vendim për miratimin e mjeteve për përmirësim profesional, arsimin plotësues dhe specializimin.

Neni 12

Të drejtat dhe detyrimet në lidhje me mjetet e miratuara për përmirësim profesional, arsimim plotësues dhe specializim, të përmendura në nenin 3 paragrafi 1, 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje, do të rregullohen më hollësisht me një kontratë që do të lidhet ndërmjet Orkestrës së Muzikës Xhaz dhe të punësuarit — paraqitës i kërkesës.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E TË PUNËSUARVE NË ORKESTRËN E MUZIKËS XHAZ TË RMV-së NË LIDHJE ME MJETET E MIRATUARA PËR PËRMIRËSIM PROFESIONAL, ARSIMIN PLOTËSUES DHE SPECIALIZIMIN

Neni 13

I punësuari të cilit do t'i miratohen dhe paguhen mjete për formën e përmirësimit profesional, arsimit plotësues dhe specializimit të përmendura në nenin 3 paragrafi 1 të kësaj Rregulloreje është i detyruar:

- Ta japë provimin përkatës brenda një viti nga dita e paraqitjes së aplikimit të parë për dhënien e provimit;

- Të mbetet në marrëdhënie pune në Orkestrën e Muzikës Xhaz për së paku tre vite nga dita e dhënies së provimit; dhe

Nëse e ndërpret marrëdhënien e punës para skadimit të afatit të parashikuar në nënparagrafin 2 të këtij neni ose nuk e jep provimin në afatin përkatës, është i detyruar t'ia kthejë Orkestrës së Muzikës Xhaz shumën e miratuar dhe të paguar me kamatë ligjore, në pajtim me dispozitat ligjore pozitive, duke u llogaritur nga dita pasuese e ditës së fundit në të cilën skadon afati për dhënien e PROVIMIT

Neni 14

I punësuari të cilit Këshilli drejtues i Institutit të Muzikës Xhaz do t'i miratojë dhe paguajë mjete për format e përmirësimit profesional, arsimimit plotësues dhe specializimit në nenin 3 paragrafët 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje, është i detyruar:

- Brenda afatit prej katër vitesh t'i përfundojë studimet pasuniversitare (magjistrale), përkatësisht brenda afatit prej gjashtë vitesh t'i përfundojë studimet doktorale;

- Në rast se nuk i përfundon studimet pasuniversitare përkatësisht doktorale brenda afatit të përcaktuar në nënparagrafin 1 të këtij neni, është i detyruar t'ia kthejë Orkestrës së Muzikës Xhaz shumën e miratuar dhe të paguar me kamatë ligjore, në pajtim me dispozitat ligjore pozitive, duke u llogaritur nga dita pasuese e ditës së fundit në të cilën skadon afati për përfundimin e studimeve pasuniversitare përkatësisht doktorale; dhe

- Të mbetet në punë në Orkestrën e Muzikës Xhaz për së paku katër vite pas përfundimit të studimeve pasuniversitare, përkatësisht të mbetet të punojë në Orkestrën e Muzikës Xhaz për së paku gjashtë vite pas përfundimit të studimeve doktorale. Afatet e përmendura në paragrafi 1 nënparagrafin 1 të këtij neni fillojnë të rrjedhin nga dita e regjistrimit në studimet pasuniversitare përkatësisht doktorale për të cilat janë miratuar dhe paguar mjetet financiare nga Orkestra e Muzikës Xhaz.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën e miratimit të saj,

Shkup, Sashko Nikolovski

Прет
НУ Ор

бор.

Kryetar i Këshillit drejtues,

IN Orkestra e Muzikës Xhaz e RMV-së